

VENDIM
Nr.831, datë 24.12.2021

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E KULTURËS DHE PËR QENDRËN KOMBËTARE TË
KINEMATOGRAFISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44, të ligjit nr.9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, t’i shtohet fondi prej 13 600 000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh, në formën e grantit për Akademinë e Filmit dhe Multimedias “Marubi”, për mbështetjen e veprimtarive krijuese.

2. Efekti financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, në masën 13 600 000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, i miratuar për vitin 2021, në artikullin 604 “Transferta të brendshme”, të programit “Arti dhe kultura”.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama